



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 4

Prishtinë, më 13 prill 2011, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L
I Mbledhjes së Komisionit të Shëndetësisë, të Punës
dhe të Mirëqenies Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Aurora Bakalli dhe Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Lejla Selimi – OSBE, Natyra Kasumaj – KDI dhe Qëndresa Ismaili - praktikante, Ervin Ibrahim - UNDP.

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 30. 03. 2011;**
- 3. Përcaktimi i një ligji për mbikëqyrje dhe formimi i grupit të punës;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 30. 03. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së 30 marsit 2011.

3. Përcaktimi i një ligji për monitorim dhe formimi i grupit të punës

Fikrim Damka - Tha se, sipas planit të punës, në këtë muaj e kemi të planifikuar ta mbikëqyrim zbatimin e një ligji. Është mirë që në këtë sesion të orientohemi në një ligj nga fusha e shëndetësisë, ndërkaq në sesionin tjetër ta marrim një ligj nga fusha sociale.

Time Kadriaj – Është mirë ta zgjedhim një ligj nga fusha e shëndetësisë, kurse më vonë edhe një ligj nga fusha e mirëqenies sociale. Megjithatë, duhet të vendosim së bashku për një gjë të këtillë.

Nazane Breca - U pajtua me këtë zgjedhje, në mënyrë që së pari të mbikëqyret zbatimi i një ligj nga shëndetësia e pastaj një nga mirëqenia sociale.

Salihe Mustafa – I kam parë rekomandimet që janë dhënë kur është mbikëqyrtur zbatimi i Ligjit për veprimtarinë private shëndetësore. Por, dua të di nëse ato rekomandime janë zbatuar.

Time Kadriaj - Propozoi të mbikëqyret Ligji për duhanin, që edhe pse ka filluar të zbatohet, ende ka ngecje në këtë drejtim. Për ta monitoruar ndonjë ligj më voluminoz dhe më të vështirë në këtë sesion kemi pak kohë.

Salihe Mustafa - Propozoi të mbikëqyret zbatimi i Ligjit për kujdesin shëndetësor emergjent.

Bahri Thaçi – U pajtua të mbikëqyret zbatimi i Ligjit për duhanin.

Aurora Bakalli – Po ashtu u pajtua të mbikëqyret zbatimi i Ligjit për duhanin.

Nazane Breca - Edhe mbikëqyrja e Ligjit për kujdesin emergjent është e rëndësishme, por për shkak të kohës së shkurtër në këtë sesion, propozoj ta mbikëqyrim zbatimin e Ligjit për duhanin.

Pas diskutimeve Komisioni njëzëri vendosi ta emërojë grupin e punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për duhanin, në këtë përbërje: Time Kadriaj, Nazane Breca, Bahri Thaçi, Gëzim Kelmendi dhe Salihe Mustafa.

4. Të ndryshme

Fikrim Damka – Si kryetar i Komisionit, së bashku me nënkryetaren, kemi pasur një takim me ministrin e Shëndetësisë, me qëllim që të mbahen kontakte më të afërta me Ministrinë. Ministri na njoftoi për rrjedhën e hartimit të Projektligjit për sigurime shëndetësore dhe të Projektligjit për shëndetësinë. Po ashtu na ftoi të marrim pjesë në procesin e hartimit të këtyre projektligjeve, në cilësinë e mbikëqyrësve.

Time Kadriaj - Me ministrin kemi biseduar rreth bashkëpunimit reciprok në fushën e shëndetësisë. Jemi pajtuar të kemi kontakte të vazhdueshme dhe jo vetëm kontakte formale me Ministrinë.

Flora Brovina - Për shkak të situatës aktuale në sektorin e farmacisë, është mirë të kontaktojmë me Shoqatën Farmaceutike të Kosovës. Komisioni duhet t'i thërrasë dhe të njoftohet për shkaqet e kësaj problematike dhe përse ka ardhur deri të greva. Në mandatin e kaluar e kemi miratuar Ligjin për produktet medicinale dhe jemi të interesuar të dimë ku qëndron problemi.

Komisioni u pajtua që të ftohen në takim përfaqësuesit nga Shoqata Farmaceutike, Doganat e Kosovës dhe Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka